



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2021

V E N D I M

Nr. 31, datë 22/02/2021

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” (i ndryshuar), Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 8, datë 08.02.2020, e znj. B. A. dhe znj. V. Y., ku pretendohet diskriminim i z. E. A. dhe z. A. F., për shkak të racës dhe etnisë, nga ana e Drejtorisë Vendore të Policisë Berat

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Ankueset B.A. dhe V.Y.janë nënat e të rinjve E. A., 27 vjeç dhe A. F., 20 vjeç, të cilët i përkasin komunitetit egjiptian të qytetit të Beratit. Ankesa në fjalë ka lidhje të drejtpërdrejtë me ngjarjen e ndodhur në datën 01.02.2021, rreth orës 22:10, në Berat, ku forcat e Policisë së Drejtorisë Vendore të Policisë kanë ndaluar dy të rinjtë e komunitetit egjiptian, pasi kanë shkelur fashën orare, të vendosur për shkak të Pandemisë së Covid-19. Ankueset shprehen se njëri prej të rinjve, përkatësisht A.F.është dhunuar nga policia, pasi i përkiste komunitetit egjiptian, ndërkohë që fashën orare e kanë shkelur edhe 2 persona të tjerë që i përkisnin maxhorancës, të cilët nuk kanë patur pasoja nga një veprim i tillë. Dy të rinjtë egjiptianë janë fyer e ofenduar nga oficerët e policisë, për shkak të racës dhe etnisë. Ankueset shprehen se kanë depozituar kallëzim penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Berat, lidhur me dhunën e ushtruar ndaj të riut Andrea Fusha. Znj. B.A. dhe znj. V.Y. pretendojnë diskriminim për shkak të racës dhe etnisë për dy të rinjtë e sipërcituar, nga ana e Drejtorisë Vendore të Policisë Berat.

Në vijim të depozitimit të ankesës nr. 8, datë 08.02.2020, përkatësisht në datën 09.02.2021, z. E. A. dhe z. A.F. kanë depozituar pranë KMD-së kërkesë për tërheqje ankese, duke theksuar se

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

nënat e tyre kanë depozituar ankesë pranë KMD-së, pa dijeninë e tyre dhe ata kërkojnë tërheqjen e saj.

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 8, datë 08.02.2020, së znj. B.A. dhe znj. V. Y., Komisioneri gjykon se:

Plotësimi i kriterëve formale të një ankese, për të vijuar me shqyrtimin administrativ të saj, është hapi i parë, që ndiqet nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në bazë parashikimeve përkatëse ligjore. Ky detyrim i Komisionerit parashikohet shprehimisht në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*” (i ndryshuar), si dhe në ligjin nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”.

Mbështetur në parashikimin e nenit 44, pika 2, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*” organi publik shqyrton paraprakisht kërkesën e depozituar nga pala, lidhur me përmbushjen e kriterëve formale ligjore, si kompetenca e organit publik, legjitimimi, afati, forma dhe çdo kriter tjetër të parashikuar nga ligji.

Në nenin 65, gërma b), të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*” parashikohet se: “*Në fillim të procedurës administrative, organi publik kryen verifikimet e mëposhtme:*

a)

b) *legjitimimin e palës që ka paraqitur kërkesën për fillimin e procedurës administrative*”.

Në pikën 1, të nenit 128, të ligjit Nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*” gjithashtu parashikohet koncepti i legjitimitetit edhe kur pala legjitimohet për të nisur një procedim administrativ. Sipas këtij neni, pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet ligjore administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj të ligjshëm çënohen nga ky veprim apo mosveprim.

Për sa më sipër, Komisioneri analizoi legjitimimin e ankueseve B.A. dhe V. Y., të cilat janë nënat e të rinjve E. A., 27 vjeç dhe Andrea Fusha, 20 vjeç. Mbështetur në aktet që përcaktojnë moshën e dy të rinjve rezultoi se ata janë madhorë, pra mbi 18 vjeç dhe mbështetur në nenin 6, paragrafi 1, i Kodit Civil², ata kanë zotësi të plotë veprimi³ dhe janë të aftë të fitojnë të drejta dhe të marrin përsipër detyrime civile. Kështu, ata kanë të drejtë të ushtrojnë vetë mjetet ligjore

² Në nenin 6, paragrafi 1, i Kodit Civil parashikohet: “*Personit kur mbush 18 vjeç, i lind zotësia e plotë që me veprimet e tij të fitojë të drejta dhe të marrë përsipër detyrime civile*”.

³ KMD nuk disponon në cilësi prove asnjë vendim gjyqësor, që provon të kundërtën.

administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendojnë se të drejtat apo interesat e tyre të ligjshme çënohen nga ky veprim apo mosveprim.

Në këto kushte, Komisioneri gjykon se ankueset B.A. dhe V.Y. nuk legjitimohen për të përfaqësuar djemtë e tyre, madhorë, pranë KMD-së, pasi ata janë mbi 18 vjeç dhe si të tillë gëzojnë të drejtën për t'u përfaqësuar personalisht, ose nëpërmjet përfaqësuesit ligjor të pajisur me akt përfaqësimi. Në këtë kontekst, Komisioneri vë në dukje faktin se ankueset nuk kanë paraqitur pranë KMD-së asnjë akt përfaqësimi për të dy të rinjtë e sipërcituar, të cilët në aktet e depozituara në datën 09.02.2021 kanë kërkuar tërheqjen e ankesës së nënave të tyre, pasi ata kanë qenë në pa dijeni të plotë mbi këtë ankesë kundër Drejtorisë Vendore të Policisë Berat.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në në nenin 18, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 6, paragrafi 1, i Kodit Civil, nenet 17 dhe 44, pika 2, nenin 65, gërma b) dhe nenit 128, pika 1, të ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenet 1, 4, 7, pika 1, 21, pika 1, neni 32, pika 1, gërma a) dhe neni 33, pika 4, gërma b), të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” (i ndryshuar), Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës nr. 8, datë 08.02.2020, së znj. B.A. dhe znj. V. Y.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim brenda afatit ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Fusha- të mira dhe shërbime
Shkak – raca, etnia
Lloji i vendimit - mosdiskriminim